




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

KRYETARI I KOMUNËS
Presednik Opštine – Municipal Mayor

**LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT,
Z. SMAJL LATIFI**

NGA DATA 01.08.2025 DERI MË 07.08.2025

NR.	EMRI I VENDIMIT	NR. I PROTOKOLLIT
1.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit.	NRP-02-6381-2025
2.	Vendim për miratimin e kërkesës për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave.	NRP-02-6382-2025
3.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-6384-2025
4.	Vendim për për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull "Lot 1 – ndërtimi i kanalit të tokave nga Shtavica deri në Fortesë"	NRP-02-6385-2025
5.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e aplikacioneve për thirrjen publike "Përkrahja e bizneseve në agroturizëm dhe ushqimet tradicionale në komunën e Rahovecit"	NRP-02-6386-2025
6.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve nga programet e veçanta të banimit social.	NRP-02-6387-2025
7.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-6388-2025
8.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-6389-2025
9.	Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve për dhënie të dekoratës për humanizëm "Dr. Ali Sokoli"	NRP-02-6392-2025
10.	Vendim për për shfuqizim të vendimit.	NRP-02-6393-2025
11.	Vendim për qasje në dokumente publike	NRP-02-6394-2025



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KOMUNA E RAHOVECI / OPŠTINA ORAHOVAC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6381 Nr. i faq/Br.str/No.pg 141

Data/Datum/Date 4 / 8 / 2025

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 21, paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2, të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, me Nr.1427, të datës 28.4.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e z. [REDAKTUAR] nga Krushë e Madhe, me Nr. Prot. 2283, të datës 7.7.2025, për ndihmë financiare prej 400.00€ (katërqind euro), për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe për blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Z. [REDAKTUAR] vuan nga sëmundja e rëndë, i cili ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj. Shërimi i sëmundjes për të lartpërmendurin ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të. Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave kanë kosto të lartë financiare, e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes së tij, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje. Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- Z. [REDAKTUAR] nga Krusha e Madhe,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.



Smajl Latifi

Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6382 Nr. i faq./Br.str./No.pg 141

Data/Datum/Date 4 / 8 / 2025

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Ndërtimi i parkingjeve të reja me ndriçim publik, hapësira të gjelbëruara dhe ndërtimi i rrugës në lagjen e komuniteteve”, me nr. prokurimi: 623-25-6259-5-2-1 dhe me nr. të brendshëm: 623-25-044-5-2-1, të datës 1.8. 2025, në këtë përbërje:

- 1.1. Jetmir Ukaj, kryesues,
- 1.2. Hashim Ibishi, anëtar (zyrtar nga MZhR-ja),
- 1.3. Faik Thaqi, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë rivlerësimin e ofertave për projektin: “Ndërtimi i parkingjeve të reja me ndriçim publik, hapësira të gjelbëruara dhe ndërtimi i rrugës në lagjen e komuniteteve”, me nr. prokurimi: 623-25-6259-5-2-1 dhe me nr. të brendshëm: 623-25-044-5-2-1, të datës 1.8. 2025.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.



Smajl Latifi

Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

Njësia Nr./Bil./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Bil./No 6384 S / 8 / 2025
Data/Datum/Date
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0028376/25, e dt. 31.07.2025 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj [redacted] nga Rahoveci me datë 31.07.2025 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehonitë (lindje) pasi që me datë 18.07.2025 ka lindur **Vajzë** në QKMF “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për znj [redacted] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi


Me vendim të njoftohen:

- Znj [redacted] nga Rahoveci,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenit 72 të Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, rekomandimit të Menaxherit të Projektit me Nr. Prot. 2536 të datës 5.8.2025 për ndërprerjen e kontratës me titull: “Lot 1 – Ndërtimi i kanalit të tokave nga Shtavica deri në Fortesë” me nr. të prokurimit 623-21-2485-5-1-1/C298, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull: “Lot 1 – ndërtimi i kanalit të tokave nga Shtavica deri në Fortesë”

1. **Miratohet** kërkesa e menaxherit të projektit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull “Lot 1 – ndërtimi i kanalit të tokave nga Shtavica deri në Fortesë” me nr. të prokurimit 623-21-2485-5-1-1/C298.
2. Ndërprerja e kontratës me marrëveshje të dyanshme sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet për shkak të prerjes së punimeve në terren.
3. Obligohet Zyra e Prokurimit që t’i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme konform dispozitave ligjore në fuqi për ndërprerjen e kontratës sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Pas zhvillimit të të gjitha procedurave të prokurimit, Komuna e Rahovecit (në vazhdim autoriteti kontraktues), ka nënshkruar kontratë publike kornizë me grupin e operatorëve ekonomikë “Fidani - L” Sh.P.K. & “Fidani – Beton” Sh.P.K. “Company Murseli” Sh.P.K. “Company Bejta Commerce” Sh.A. (në vazhdim kontraktuesi), me titull “Lot 1 – Ndërtimi i kanalit të tokave nga Shtavica deri në Fortesë” me nr. të prokurimit 623-21-2485-5-1-1/C298.

Pas nënshkrimit të kontratës, autoriteti kontraktues ka kryer punët sipas kushteve të parapara në kontratë.

Mirëpo, gjatë ekzekutimit të punimeve, kontraktuesi, më datë 22.7.2025 ka bërë kërkesë të menaxheri i kontratës për prerjen e shërbimeve dhe punimeve në terren.

Pas kësaj kërkesë të kontraktuesit, menaxheri i kontratës, më datë 5.8.2025, i është drejtuar kryetarit të Komunës me kërkesë/rekomandim për ndërprerjen e kontratës me titull “Lot 1 – ndërtimi i kanalit të tokave nga Shtavica deri në Fortesë” me nr. të prokurimit 623-21-2485-5-1-1/C298, sipas kërkesës së arsyetuar të operatorit ekonomik.

Për këtë arsye, pas kërkesës së pranuar të kontraktuesit, të datës 22.7.2025, si dhe rekomandimit të menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, me nr. prot. 2536, të datës 5.8.2025, për ndërprerjen e kontratës me titull “Lot 1 – ndërtimi i kanalit të tokave nga Shtavica deri në Fortesë” me nr. të prokurimit 623-21-2485-5-1-1/C298, për shkak të arsyeve të lartcekura.

Pas administrimit të të gjitha provave, kryetari i Komunës ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme me titull “Lot 1 – ndërtimi i kanalit të tokave nga Shtavica deri në Fortesë” me nr. të prokurimit 623-21-2485-5-1-1/C298.

Nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të tij në autoritetin kontraktues.

Me vendim të njoftohen:

- ***Zyra e Prokurimit,***
- ***Menaxheri i projektit,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të projektit, dhe***
- ***Arkivi.***





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6386 Nr. i faq./Br.str./No.pg 141

Data/Datum/Date 5 / 8 / 2025

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 69 dhe nenit 92 të Statutit të Komunës, Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e aplikacioneve

1. Caktohet komisioni për vlerësimin e aplikacioneve në bazë të thirrjes publike për aplikim “Përkrahja e bizneseve në agroturizëm dhe ushqimet tradicionale në komunën e Rahovecit”, me nr. prot. 2344, e datës 11.7.2025, në këtë përbërje:
 - 1.1. Fidan Hoti, kryesues,
 - 1.2. Saranda Shala, anëtare,
 - 1.3. Kaltrina Duraku, anëtare,
 - 1.4. Nazmi Bellaqa, anëtar nga shoqëria civile,
 - 1.5. Mimoza Ejupi, anëtare.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin e aplikacioneve në bazë të thirrjes publike për aplikim “Përkrahja e bizneseve në agroturizëm dhe ushqime tradicionale në komunën e Rahovecit”.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga kryetari i Komunës.

U dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6387 Nr. i faq./Br.str./No.pg 141

Data/Datum/Date 5 / 8 / 2025

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-164 për Financimin e Programve të Veçanta të Banimit, si dhe në pajtim me nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.22/2010 për Porcedurat e Përfitimit nga Programet e Veçanta të Banimit, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës 29.03.2017 dhe thirrjes publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve nga programet e veçanta të banimit social

1. Caktohet komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve nga programet e veçanta të banimit social adekuat përmes nënprojekteve sipas thirrjes publike, në këtë përbërje:
 - 1.1. Diellza Çanta, kryesuese,
 - 1.2. Shpejtim Mustafa, koordinator,
 - 1.3. Sylejman Daka, anëtar,
 - 1.4. Ylfete Kryeziu, anëtare,
 - 1.5. Samir Mustafa, anëtar.
2. Komisioni i përshkruar si në pikën e parë (1) të këtij vendimi, duhet t'i ndërmarrë të gjitha veprimet konform Ligjit Nr. 03/L-164 për financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, si dhe akteve nënligjore që burojnë nga ky ligj.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit, dhe
- Arkivit.


Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa [redacted] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0029065/25, e dt. 05.08.2025 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj. [redacted] nga Rahoveci me datë 05.08.2025 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoninë (lindje) pasi që me datë 29.07.2025 ka lindur **Djal** në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për znj. [redacted] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- Znj. [redacted] nga Rahoveci,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0029039/25, e dt. 05.08.2025 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Zn. [redacted] nga Rahoveci me datë 05.08.2025 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehonin (lindje) pasi që me datë 26.07.2025 ka lindur **Vajzë** në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për zn. [redacted] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- Znj. [redacted] nga Rahoveci,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6392 Nr. i faq./Br.str./No.pg 142

Data/Datum/Date 6 / 8 / 2025

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”), nenit 4 paragrafi 5 të Rregullores për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit me Nr. Prot. 01 Nr. 327/22 e datës 31.05.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve për dhënien e dekoratës për humanizëm “Dr. Ali Sokoli”

1. Caktohet komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve për dhënien e dekoratës për humanizëm “Dr. Ali Sokoli”, në këtë përbërje:
 - 1.1. Elbunit Kryeziu, kryesues,
 - 1.2. Qemajl Krasniqi, anëtar,
 - 1.3. Ardian Rama, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha propozimeve, si dhe përzgjedhjen e personalitetit për dhënien e dekoratës për humanizëm “Dr. Ali Sokoli”, duke u bazuar në Rregulloren për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit me nr. prot. 01 Nr. 327/22 e datës 31.5.2022.
3. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri më datë 11.8.2025, kur edhe do t’i rekomandojë kryetarit të Komunës personalitetin e vitit për dhënien e dekoratës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA E KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6333 Nr. i faq./Br.str./No.pg 742
Data/Datum/Date 7 / 8 / 2025
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 të datës 25.05.2016 dhe nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit nr. 02/6376/25 i datës 31.7.2025

1. Me këtë vendim **shfuqizohet** vendimi nr. 02/6376/25 i datës 31.7.2025, me të cilin z. Shpejtim Mustafa, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës arkitekt, në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në Komunën e Rahovecit, ka qenë i caktuar:

1.1. Zyrtar përgjegjës (administrator) për regjistrimin dhe administrimin e kërkesave për banim social.

2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset z. Shpejtim Mustafa dhe Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Z. Shpejtim Mustafa,
- Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, kërkesës së ushtruar nga z.Vatan Hamëz Dina, me nr. prot.6379, të datës 1.8.2025, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për qasje në dokumente publike

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me nr. prot. 6379, e datës 1.8.2025 për qasje në dokumente publike nga Vatan Hamëz Dina dhe i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike dhe atë në: Informacione (dokumente) lidhur me ndonjë kërkesë për legalizim apo leje ndërtimi nga Ruzhdi Shaqir Dina, Alemi Shaqir Dina, Hadi Shaqir Dina, për ndonjë objekt të ndërtuar mbi pronën trashëgimore të të ndjerit Shaqir Dina në fshatin Celinë.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 6379. të datës 1.8.4.2025 për qasje në dokumente publike nga Vatan Hamëz Dina.

Pas shqyrtimit të kërkesës, ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike dhe atë në: Informacione (dokumente) lidhur me ndonjë kërkesë për legalizim apo leje ndërtimi nga Ruzhdi Shaqir Dina, Alemi Shaqir Dina, Hadi Shaqir Dina, për ndonjë objekt të ndërtuar mbi pronën trashëgimore të të ndjerit Shaqir Dina nga fshati Celinë, komuna e Rahovecit.

Kërkesa për qasje në dokumente publike është pranuar në mënyrë elektronike.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të tij.

Vendimi u dërgohet:

- Znj. Blerta Gashi, zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP-së,
- Z. Vatan Hamëz Dina, dhe
- Arkivit.

